



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ  
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati  
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia  
Bashkiake Nr. 5  
TEL: 698227426



# MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE SIGURUESE MBI 20,000,000 LEKË)

Nr. repertori: 5885

Nr. koleksioni: 3950

Tirane më 01/08/2024


Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

\*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2024053150406857362



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NR. 5885 REP.  
NR. 3850 KOL.

TAKSA E PULLES  
U PAGUA  
ERMAL HAMZAJ

### MARRËVESHJE SIGURUESE

Sot më datë 01/08/2024, përpara meje, Noteres ..... Ermal Hamzaj .....  
anetare e Dhomes se Noterisë Tiranë, me Zyrë Noteriale në Tirane, Poshtke 1050, u  
paraqitën palët si më poshtë:

**BARRËDHËNËSI:** "GREEN COAST" SHPK, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) L41329038D, me seli në Rruga Tish Daija, kompleksi Kika 2, godina 3, kati 1, Tirane; përfaqësuar nga **Z. Armando Alicanaj**, shtetas shqiptar, atësia Zenel, lindur në Fier, më dt. 05.10.1979, banues ne Tiranë, mbajtës i Pasaportës me Nr. BC5216331 dhe numer personal H91005012U, në cilësinë e Administratorit; në përputhje me Vendimin e Asamblesë së Ortakeve datë 01/08/2024 (më poshtë referuar si "**Barrëdhënës**").

dhe,

**BARRËMARRËSI:** "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA, me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) J81817006P, regjistruar me Vendim nr. 19460, datë 19.05.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli në Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar prej **Z. Andi Çeku**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 06.09.1981, me Letërnjoftim me nr. personal I10906034E dhe nga **Z. Ermal Shyti**, shtetas shqiptar, lindur ne Fier, me 27.03.1986, identifikuar me Letërnjoftimin me nr. personal I60327022D, në cilësinë e përfaqësuesve të Bankës (më poshtë referuar si "**Barrëmarrës**").

me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilëve, unë noterja jam e sigurt, të cilët më deklaruan se:

#### Meqënëse:

- Barrëmarrësi në cilësinë e Kredihënësit ka lidhur me Kredimarrës: "GREEN COAST" SHPK (këtu e më poshtë referuar si "**Kredimarrës**") Kontratën e Kredisë Bankare nr. 5883 rep./nr. 3848 kol., datë 01/08/2024 (këtu e më poshtë referuar si "**Kontrata e Kredisë**"), me shumë principali **EURO 26,000,000** (njëzetë e gjashtë milionë) (këtu e më poshtë referuar si "**Principali**");
- Për qëllime të garantimit të shlyerjes së detyrimeve që lindin për '**Kredimarrësin**' nga '**Kontrata e Kredisë**', kërkohet barrë siguroese në favor të Barrëmarrësit mbi kolateralin – objekt të kësaj marrëveshje siguroese;

#### Atëherë,

Palet, me vullnet të lirë dhe të plotë, bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Siguroese me përmbajtjen si më poshtë vijon:

## Neni 1 - Përkufizime

1.1 Kudo, ku përdoren në këtë Marrëveshje Siguruese, dhe vetëm nëse shprehimisht nuk parashikohet ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- “*Kolateral*” – nënkupton pasurinë e luajtshme (të prekshme apo të paprekshme), objekt i kësaj Marrëveshje Siguruese. Kolaterali mund të ekzistojë ose mund të krijohet në të ardhmen dhe nuk kufizohet vetëm me pasuritë e luajtshme mbi të cilat Barrëdhënësi ka pronësinë apo një të drejtë të tashme. Kolaterali mund të ndodhet kudo, brenda apo jashtë Shqipërisë, dhe përfshin edhe të ardhurat kolateral. Përshkrimi i Kolateralit jepet në nenin 2.1 të kësaj Marrëveshje Siguruese.
- “*Barrë Siguruese*” – nënkupton të drejtën reale mbi ‘*Kolateralin*’, nëpërmjet se cilës sigurohet përmbushja e detyrimeve të rrjedhura për ‘*Kredimarrësin*’ nga ‘*Kontrata e Kredisë*’.
- “*Cash*” do të thotë paratë e kredituara në një llogari në çfarëdo lloji valute apo pretendime të ngjashme të ripagueshme të parave, të tilla si depozitat monetare dhe të ardhurat e arkëtueshme të pagueshme në llogaritë bankare çelur prane Barremarresit, për të garantuar detyrimet financiare të Barredhenesit ndaj Barremarresit, përfshirë ato të tashmet ose të ardhmet, ato aktuale ose të kushtëzuara apo të mundshme.
- “*Detyrime të Siguruara*” – nënkupton detyrimin, që ka ‘*Kredimarrësi*’ për të përmbushur të gjitha detyrimet sipas ‘*Kontratës së Kredisë*’, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në pagimin e shumës totale të ‘*Principalit*’, interesave dhe penaliteteve deri në ditën e shlyerjes totale të të gjitha detyrimeve të ‘*Kredimarrësit*’, së bashku më çdo shumë tjetër sipas ‘*Kontratës së Kredisë*’, si dhe pagimin e çdo shpërblimi, shpenzimi, ose pagesa të tjera të lidhura me ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve të ‘*Kredimarrësit*’ sipas ‘*Kontratës së Kredisë*’ dhe Legjislacionit Shqiptar.
- “*Llogari Bankare*” nënkupton te gjitha llogarite rrjedhëse, çdo llogari tjetër bankare, depozita bankare dhe garanci, te tashme dhe te ardhme qe Barredhënësi ka pranë Barrëmarrësit.

## Neni 2 - Barra Siguruese

2.1. Me qëllim që të sigurojë ekzekutimin e plotë të ‘*Detyrimeve të Siguruara*’ të rrjedhura për ‘*Kredimarrësin*’ nga ‘*Kontrata e Kredisë*’, ‘*Barrëdhënësi*’, nëpërmjet kësaj Marrëveshje Siguruese, vendos në favor të ‘*Barrëmarrësit*’, ‘*Barrë Siguruese*’ **të radhës së parë** mbi ‘*Kolateralin*’ e përshkruar më poshtë:

- *Llogarite Bankare qe Barrëdhënësi ka aktualisht ose do te ketë pranë Barrëmarrësit duke përfshirë të gjitha shumat, kreditimet dhe të drejtat monetare së bashku me interesat e pretenduara ose të kredituara në llogarite ku të gjitha vlerat e arkëtueshme mbahen, depozitohen dhe përdoren nga Barrëdhënësi;*  
*Llogarite e çelura aktualisht pranë Bankës janë llogarite me te dhënat identifikuese si me poshtë:*

1. *Nr. i llogarisë 212030035301 IBAN AL69208110080000212030035301 monedha ALL*
2. *Nr. i llogarisë 212030035302 IBAN AL42208110080000212030035302 monedha EUR*

- *Llogarinë DSRA (Debt Service Reserve Account) me nr. Llogarie 212030035303 – IBAN AL15208110080000212030035303 ne monedhën EURO e çelur si llogari rezerve pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania Sha, e cila sherben si garanci per pagesen e kesteve te kredisë objekt i Kontratës se Kredisë Bankare me nr. 5883 rep./ 3948 kol. date 01 . 08 .2024.*

- *Te ardhurat e arkëtueshme te tashme apo te ardhshme si dhe te gjitha te drejtat dhe pretendimet mbi to që ekzistojnë në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe në çdo moment në të ardhmen deri në përmbushjen/shlyerjen e plotë të Detyrimeve të Siguruara.*

2.1.1 “Barra siguruose” do përfshijë automatikisht (i) të gjitha vlerat ekzistuese dhe të ardhshme të cilat kreditohen herë pas here në Llogaritë Bankare dhe/ose të drejtën për pagimin e një detyrimi monetar si të arkëtueshme; (ii) çdo dhe të gjitha pretendimet në bazë të ose në lidhje me llogaritë bankare dhe/ose të arkëtueshmet; (iii) çdo të drejtë për ripagimin e shumave të cilat përbëjnë fondet që janë kredituar në llogaritë bankare dhe/ose pagesës së një detyrimi monetar si të arkëtueshme; dhe (iv) çdo interes të përlllogaritur ose që do të përlllogaritet mbi shumat e përcaktuara në këtë nen.

2.2. ‘Barra Siguruose’ e krijuar sipas kesaj Marrëveshje do të jetë detyruese e do të mbetet në fuqi për ‘Barrëdhënësin’, pasardhësit e tij apo posedues dhe përfitues të tjerë të Kolateralit, dhe do të përbëjë një garanci të panderprerë, pavarësisht nga shlyerja e pjeshme e ‘Detyrimeve të Siguruara’ dhe nuk do të çenohet nga ndonjë barrë, garanci apo mjet tjetër sigurimi të vendosur në favor të ‘Barrëmarrësit’ nga ‘Barrëdhënësi’ apo të tretë.

### Neni 3 – Regjistrimi i Barrës Siguruose

3.1. Nëpërmjet kësaj Marrëveshje Siguruose, ‘Barrëdhënësi’ jep miratimin e tij, që sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të ‘Barrëmarrësit’, ‘Barra Siguruose’ e krijuar me këtë Marrëveshje Siguruose, të regjistrohet nga ‘Barrëmarrësi’ me shpenzimet e ‘Barrëdhënësit’, në Regjistrin e Barrëve Siguruose, në përputhje me Ligjin nr. 85737, datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruose”, i ndryshuar.

3.1.1. Përveç regjistrimit në Regjistrin e Barrëve Siguruose, ‘Barrëdhënësi’ jep miratimin e tij, që sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të ‘Barrëmarrësit’, ‘Barra Siguruose’ dhe/ose kjo ‘Marrëveshje Siguruose’ të regjistrohet, me shpenzimet e ‘Barrëdhënësit’, edhe në regjistra apo regjistrarë kompetentë, nëse në varësi të llojit të ‘Kolateralit’, një regjistrim i tillë është apo do të bëhet i nevojshëm sipas legjislacionit të zbatueshëm.

3.2. ‘Barrëdhënësi’ kupton plotësisht dhe bie dakord se nëse ‘Barrëmarrësi’ është ose vihet në posedim të ‘Kolateralit’, atëherë për efekte të preferimit kundrejt të tretëve sipas Ligjit nr. 85737, datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruose”, i ndryshuar, barra siguruose do të konsiderohet e kompletuar edhe me anë të vendosjes së ‘Barrëmarrësit’ në posedim të ‘Kolateralit’.

3.3. ‘Barrëmarrësi’ merr përsipër se do të bëjë të mundur heqjen e barrës siguruose mbi ‘Kolateralin’, vetëm pas përmbushjes së plotë të të gjitha ‘Detyrimeve të Siguruara’.

3.4. ‘Barrëdhënësi’ i jep të drejtë ‘Barrëmarrësit’, që me shpenzimet e ‘Barrëdhënësit’ të tërheqë nga organet kompetente, në çdo moment dokumentacionin provues të regjistrimit të ‘Barrës Siguruose’, ose vërtetimet mbi gjendjen juridike të ‘Kolateralit’.

### Neni 4 – Deklarime dhe Garanci të ‘Barrëdhënësit’

4.1. ‘Barrëdhënësi’ deklaron dhe garanton ‘Barrëmarrësin’, se mbi ‘Kolateralin’ objekt të kësaj Marrëveshje Siguruose, nuk rëndon asnjë barrë siguruose (përveç sa shprehimisht parashikohet në këtë Marrëveshje Siguruose) në lidhje me ndonjë detyrim tjetër, dhe se ‘Barrëdhënësi’ është titullari i vetëm i pronësisë mbi ‘Kolateralin’.

4.2. ‘Barrëdhënësi’ merr përsipër, që deri në momentin e shlyerjes së plotë të të gjitha ‘Detyrimeve të Siguruara’, të mos kryejë mbi ‘Kolateralin’ asnjë veprim juridik barrësimi, tjetërsimi, disponimi (material apo juridik), ndarje, bashkimi, pjestimi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të ‘Barrëmarrësit’.

4.3. ‘Barrëdhënësi’ kupton plotësisht dhe pranon që në qoftë se ‘Kolaterali’ humbet ose dëmtohet qoftë dhe për rast faktor, në mënyrë që të mos dëmtohen të drejtat e ‘Barrëmarrësit’, kjo e fundit mund të kërkojë nga ‘Barrëdhënësi’, që t’i jepet garanci e plotë mbi sende të tjera dhe, në mungesë të saj, mund të kërkojë pagesën e menjëhershme të detyrimeve të rrjedhura nga ‘Kontrata e Kredisë’. I njëjti rregullim do të jetë i zbatueshëm edhe nëse ‘Barra Siguruose’ humbet ose çenohet pjesërisht apo totalisht, nga ndonjë e metë juridike e titullit të pronësisë apo e statusit juridik të ‘Kolateralit’.

4.4. ‘Barrëdhënësi’ kupton plotësisht dhe pranon që në rast të fillimit nga ana e ‘Barrëmarrësit’ të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm për detyrimet e ‘Kredimarrësit’ të rrjedhura nga ‘Kontrata e Kredisë’, ‘Kolaterali’ sipas gjykimit dhe diskrecionit të vetëm të ‘Barrëmarrësit’ do t’i nënshtrohet procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, pavarësisht nëse kanë filluar ose jo procedurat përbarimore edhe mbi pasuritë e tjera të luajtshme apo të paluajtshme të ‘Kredimarrësit’, ose Dorezanësit(ve), ose

mbi pasuri tjetër të vendosur në hipotekë apo në barrë siguroese në favor të ‘Barrëmarrësit’ si garanci për shlyerjen e ‘Detyrimeve të Siguruara’.

4.5. ‘Barrëdhënësi’ deklaron se kupton plotësisht, dhe bie dakord që, ‘Barra Siguroese’ e krijuar në bazë të kësaj Marrëveshje Siguroese, duke qënë një e drejtë reale me titullar ‘Barrëmarrësin’, nuk do të çënohet apo preket, pavarësisht nëse ‘Barrëmarrësi’ dhe ‘Kredimarrësi’ vendosin të ndryshojnë kushtet e ‘Kontratës së Kredisë’ dhe për këtë qëllim nënshkruajnë me njëra – tjetrën amendamente të ‘Kontratës së Kredisë’.

4.6. ‘Barrëdhënësi’ deklaron se kupton plotësisht që kjo Marrëveshje Siguroese përbën titull ekzekutiv dhe se nëse ndodh një ‘Rast Shkakësor’ (‘Event of Default’) sikundër përcaktohet në ‘Kontratën e Kredisë’, atëherë ‘Barrëmarrësi’ sipas vendimit dhe diskrecionit të vetëm të tij, do të mund të fillojë kërkimin e shlyerjes së ‘Detyrimeve të Siguruara’ nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm të ‘Kolateralit’, duke u bazuar në Ligjin nr. 85737, datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguroese”, i ndryshuar si dhe në “Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”.

#### Neni 5 - Detyrime të Barrëdhënësit

5.1. ‘Barrëdhënësi’ do të përmbushë të gjitha detyrimet e parashikuara për të, në këtë Marrëveshje Siguroese dhe legjislacionin në fuqi, si dhe do të respektojë cdo deklarim dhe garanci të dhënë në këtë Marrëveshje Siguroese.

5.2. ‘Barrëdhënësi’ do të mbajë ‘Kolateralin’ në kushte të mira dhe do të kryejë të gjitha riparimet e nevojshme të tij, dhe nuk do të kryejë apo lejojë asnjë humbje apo dëmtim material të ‘Kolateralit’.

5.3. Nëse do t’i kërkohet nga ana e ‘Barrëmarrësit’, ‘Barrëdhënësi’ do të sigurojë ‘Kolateralin’ në favor të ‘Barrëmarrësit’, për të gjithë shumën e ‘Principalit’ dhe për të gjithë kohëzgjatjen e ‘Kontratës së Kredisë’, përkundrejt çdo lloj rreziku që do t’i kërkohet nga ana e ‘Barrëmarrësit’. ‘Barrëdhënësi’ do të mbajë të përgjigjetuar ‘Barrëmarrësin’ nga përgjegjësia për kryerjen e pagesave të shpenzimeve për sigurimin e ‘Kolateralit’.

5.4. ‘Barrëdhënësi’ garanton ‘Barrëmarrësin’ lidhur me vlefshmërinë e ‘Barrës Siguroese’ të krijuar në favor të ‘Barrëmarrësit’ në bazë të kësaj Marrëveshje Siguroese, si dhe përkundrejt çdo të metë juridike që mund të çënojë ‘Barrën Siguroese’. Në këtë kuadër, ‘Barrëdhënësi’ detyrohet të marrë pjesë në gjykimin e cdo çështje gjyqësore në mbrojtje të interesave të ‘Barrëmarrësit’, dhe zgjidhë konfliktin në favor të ‘Barrëmarrësit’. Në rast se ‘Barrëmarrësi’ i çënohet ‘Barra Siguroese’, qoftë pjesërisht apo edhe tërësisht, atëherë ‘Barrëdhënësi’ do të jetë i detyruar personalisht me të gjithë pasurinë e vet të luajtshme apo të paluajtshme, për shlyerjen e detyrimeve të ‘Kredimarrësit’ të rrjedhura nga ‘Kontrata e Kredisë’.

5.5. Në rast se persona të tretë pretendojnë të drejta pronësie, posedimi, uzufukt, enfiteoze, apo të drejta përdorimi ose ndonjë të drejtë tjetër reale, ‘Barrëdhënësi’ garanton se do të ruajë të pacënuar ‘Barrën Siguroese’ të ‘Barrëmarrësit’ mbi ‘Kolateralin’.

5.6. ‘Barrëdhënësi’ do të pranojë dhe lejojë punonjësit e ‘Barrëmarrësit’, që me kërkesën e tyre, të inspektojnë dhe monitorojnë gjëndjen e ‘Kolateralit’. Gjithashtu, ‘Barrëdhënësi’ bie dakord dhe pranon, që nëse do të kërkohet nga ‘Barrëmarrësi’ rivlerësimi i ‘Kolateralit’ nga ekspertë vlerësues, të lejojë kryerjen e rivlerësimit si dhe të mbulojë shpenzimet e lidhura me rivlerësimin përkundrejt ekspertit vlerësues të zgjedhur nga ‘Barrëmarrësi’.

#### Neni 6 – Të ndryshme

6.1. Çdo njoftim ose kërkesë do të konsiderohet i kryer kur bëhet me shkrim dhe dërgohet në adresat e parashikuara për palët në këtë Marrëveshje Siguroese.

6.2. Në rast se ndonjë klauzolë ose detyrim sipas kësaj Marrëveshje Siguroese do të jetë apo shpallet e pavlefshme, e kundërligjshme ose e pazbatueshme, - vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e klauzolave ose e detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Marrëveshje Siguroese, nuk do të çënohen apo ndikojnë në zbatim.

6.3. Në zbatim të nenit 127 të Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Rregullores Nr. 72/2020 të Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e regjistrit të kredive në Bankën e Shqipërisë, si dhe kushtet dhe procedurat për njohjen, përdorimin dhe rishikimin e të dhënave që administrohen në të” të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, ‘Barrëdhënësi’ nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate: (i) deklaron dhe garanton me vullnetin e plote dhe të lirë se informacioni i dhënë, është i vërtetë, i saktë dhe i plotë, si dhe (ii)

kupton se të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave; si dhe (iii) autorizon “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SH.A, që për qëllimet që përfshijnë: 1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi; 2. Vlerësimin e rrezikut të kredisë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies të kredisë me Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A; 3. Vlerësimin e besueshmërisë si person i lidhur me kredimarrësit; - të njihet me detyrimet e ‘Barredhenesit’ ndaj institucioneve financiare kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave të Regjistrin të Kredive, për të vlerësuar vlerën e ekspozimit kreditor në sistemin bankar e financiar, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer detyrimet financiare.

6.3.1 ‘Barredhenesi’ jep pëlqimin që Banka Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A të përdorë emrin dhe të dhënat identifikuese dhe financiare të ‘Barredhenesit’ për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

6.3.2 ‘Barredhenesi’ deklaron se është informuar siç duhet për të drejtën për të kërkuar informacion mbi të dhënat e ‘Barredhenesit’ gjatë periudhës së mbajtjes së tyre nga Banka Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A si dhe korrigjimin/rishikimin në raste kur ato janë të pa sakta, të paplota duke kuptuar se çdo kërkesë për sa më sipër mund t’ia drejtoje Bankes Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A sipas detajeve të mëposhtme:

Në vëmendjen e: Departamentit të Analizës dhe Administrimit të Portofolit të Kredive

Adresa: Rr. "Ismail Qemali" No.27, Tirana, Albania

E-mail: [KorrigjimRegjistriKredive@intesasanpaolobank.al](mailto:KorrigjimRegjistriKredive@intesasanpaolobank.al)

Telefoni: +355 4 227 60000

Faqja e internetit: [www.intesasanpaolobank.al](http://www.intesasanpaolobank.al)

6.3.3 Banka do të njoftojë ‘Barredhenesin’ pas mënyrave të përcaktuara në këtë kontratë, për çdo ndryshim eventuale të adresave të kontaktit të përcaktuara më lart.

6.3.4 ‘Barredhenesi’ deklaron se njëj pasojat përkatëse ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, informacionit financiar dhe/ose çdo informacioni tjetër në lidhje me cilësinë e ‘Barredhenesit’

6.4. Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ‘Barrëdhënësi’ në mënyrë të përvokueshme autorizon “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SHA të transferojë dhe të trajtojë të gjitha të dhënat personale dhe financiare të tij (më poshtë referuar si “Informacioni Konfidencial”) me dhe tek Shoqëria Mëmë e saj: “Intesa Sanpaolo” S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqëria Mëmë: “Intesa Sanpaolo” S.p.A. ‘Barrëdhënësi’, duke kuptuar se të dhënat e tij personale dhe financiare do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe profesional, si dhe duke marrë në konsideratë gjithashtu se “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SHA dhe Shoqëria Mëmë e saj: “Intesa Sanpaolo” S.p.A kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin e sigurt të të dhënave të ‘Barrëdhënësit’, autorizon “Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, - që për qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit të ‘Kredimarrësit’ për kredi; dhe/ose 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë afatit të marrëveshjes kontraktore të kredisë së ‘Kredimarrësit’ me “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SHA; dhe/ose 3. vlerësimin e besueshmërisë së ‘Kredimarrësit’ së bashku me palët e treta të lidhura me ‘Kredimarrësit’; dhe/ose 4. mbikëqyrja e konsoliduar nga Shoqëria Mëmë: “Intesa Sanpaolo” S.p.A (duke përfshirë por pa u kufizuar tek qëllimet e konsolidimit të pozicioneve të mëposhtme: (a) kapitalin rregullator, (b) mjaftueshmërinë e kapitalit, (c) ekspozimi i rrezikut, (d) pozicionet e hapura të këmbimeve valutore, (e) investimet në institucionet kapitale dhe jo kapitale); dhe/ose 5. monitorimi dhe procesi i administrimit të rreziqeve të bankës dhe rrezikut të Grupit Bankar Intesa Sanpaolo, ose me konsolidimin e pozicioneve që parashikohen në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar - për të transferuar dhe trajtuar të gjitha të dhënat personale dhe financiare me dhe tek Shoqëria Mëmë e saj: “Intesa Sanpaolo” S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqëria Mëmë: “Intesa Sanpaolo” S.p.A. Në përputhje me sa më sipër, ‘Barrëdhënësi’ autorizon “Intesa Sanpaolo” S.p.A të ketë akses, të përdorë dhe të trajtojë të

dhënat personale dhe financiare që zotëron "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe/ose kjo e fundit merr në zotërim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu pranohet se i gjithë Informacioni Konfidencial do të mbrohet përpara keqpërdorimit, dëmtimit, shkatërrimit, zhvlerësimit, humbjes dhe vjedhjes dhe "Intesa Sanpaolo" S.p.A nuk do të përdorë Informacionin Konfidencial për asnjë qëllim tjetër përveçse për qëllimet që përcaktohen më sipër, si dhe nuk do t'i zbulohen, vihen në dispozicion, publikohen ose përhapen palëve të treta. "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojë që vetëm personat përgjegjës (duke përfshirë Nën-kontraktorët dhe Filialet) të cilëve u zbulohet informacioni në funksion të përmbushjes së qëllimeve të parashikuara më sipër, do të kenë akses të Informacionit Konfidencial. Informacioni konfidencial mund të zbulohet deri në masën e parashikuar me ligj gjykatës, zyrës së prokurorisë dhe organeve të tjera kompetente që gëzojnë këtë të drejtë në bazë të ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme, një gjykatësi ose çdo autoriteti rregullator. "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe Shoqëria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A do të sigurojnë respektimin nga ana e Personelit të saj (duke përfshirë Nënkontraktorët dhe Filialet) të detyrimeve për konfidencialitetin e marrë përsipër.

6.5. Gjithashtu, përvec sa përcaktohet në nenin 6.4, '*Barrëdhënësi*' në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar (duke përfshirë ketu por duke mos u kufizuar tek neni 6 pika 1 shkronja "a", nenin 8, si dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe nën-ligjore të aplikueshme) dhe Ligjit Nr. 9662 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar jep pëlqimin dhe autorizon Bankën, të përpunojë, transferojë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare të tij, me dhe tek cdo subjekt i treta, i cili kryen një ose disa shërbime në emër dhe për llogari të Bankës (duke përfshirë edhe nën-kontraktorët e tyre), me vendndodhje si brënda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të kontraktuar nga Banka sipas diskrecionit të Bankës, për qëllime të ushtrimit, monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm, të aktivitetit të saj bankar dhe financiar; megjithatë duke parashikuar shprehimisht ketu se subjektet e tretë (duke përfshirë edhe nën-kontraktorët e tyre) do të jenë gjithashtu përgjegjës dhe kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale dhe financiare të '*Barrëdhënësi*'.

6.5.1 Banka garanton '*Barrëdhënësin*' se përpunimi i të dhënave do të menaxhohet nga stafi teknik i zyrës përgjegjëse për trajtimin e të dhënave personale dhe do të bëhet në përputhje me menyrat e parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

6.5.2 '*Barrëdhënësi*' nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Bankës, ka të drejtë (i) të marri në çdo kohë konfirmimin për përpunimin ose jo të të dhënave personale të tij, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale të '*Barrëdhënësit*'; (ii) të njihet me përmbajtjen dhe burimin e të dhënave personale të përpunuara nga Banka; (iii) të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e tyre kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar; (iv) të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij. '*Barrëdhënësi*' gëzon të drejtën e ankimit në rast se pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm në lidhje me të dhënat personale. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, Banka nuk do të kryejë ndryshime në të dhënat e tij personale deri në dhënien e vendimit. '*Barrëdhënësi*', të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim Bankës për dëmin e shkaktuar.

6.6. Banka ka të drejtë që të cedojë tek personat e tretë, tërësisht ose pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga '*Kontrata e Kredisë*', në bazë të gjykimit dhe vendimit të saj dhe pavarësisht nëse '*Kredimarrësi*' ndodhet ose jo në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore. '*Barrëdhënësi*' deklaron se kupton dhe pranon që Banka do të mund të disponojë lirisht dhe të kalojë '*Kontratën e Kredisë*' dhe rrjedhimisht dhe kete Kontrate, me ose pa shpërblim, më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm. Në këtë rast Banka do të njoftojë me shkrim *Barrëdhënësin* për këtë kalim.

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate '*Barrëdhënësi*' bie dakord të pranojë dhe ekzekutojë të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate kundrejt palës së tretë, në përputhje me Marrëveshjen e Cedimit apo Kalimit të Kontratës së Kredisë.

Për të bërë të mundur realizimin e këtij cedimi të drejtash apo kalimi kontrate, sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, '*Barrëdhënësi*' në mënyrë të

parevokueshme autorizon Bankën t'i japë të dhënat personale dhe financiare të tij, të nevojshme përpara, gjatë dhe pas lidhjes së Marrëveshjes së Cedimit (duke përfshirë edhe, por pa qënë i kufizuar në shitjen apo në një formë tjetër të disponimit të kontratës) kujtdo pale me të cilën Banka dëshiron të hyjë në këtë marrëdhënie cedimi apo kalimi kontrate.

6.6.1 Përvec rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj apo në aktet nën-ligjore të zbatueshme, 'Barrëdhënësi' nëpërmjet kësaj Kontrate, jep pëlqimin në mënyrë të parevokueshme se në rast mospërbushje të detyrimeve kontraktore sipas 'Kontratës së Kredisë' nga ana e 'Kredimarrësit', Banka në kuadër të rekuperimit të kredisë, pavarësisht nëse ka ndërmarrë ose jo veprimet procedurale përbarimore, do të ketë të drejtë të përhapë, transferojë dhe/ose të përpunojë të dhënat personale dhe financiare të 'Barrëdhënësi', me cdo subjekt tjetër, në kuadër të vlerësimit paraprak apo realizimit të kalimit të Kontratës së Kredisë dhe rrjedhimisht dhe këtë Kontratë (nëpërmjet shitjes apo forma të tjera të disponimit, me ose pa shpërblim), më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.

#### Neni 7- Legjislacioni që zbatohet

Kjo Marrëveshje Siguruese është objekt dhe është hartuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim i lindur ose i lidhur me këtë Marrëveshje Siguruese do të shqyrtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

\*\*\*\*

Kjo Marrëveshje Siguruese u hartua në 3 (tre) kopje të njëjta e të barazvlefshme në gjuhën shqipe. Secila nga palët mban nga një kopje; dhe një kopje e Marrëveshjes Siguruese ruhet në Zyrën Noteriale. Interpretimi i kushteve kontraktore do të bëhet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe qëllimin e palëve për të lidhur këtë Marrëveshje Siguruese.

Unë Noterja, ua lexova me zë të lartë palëve tekstin e kësaj Marrëveshje Siguruese dhe i njoha palët me efektet ligjore të saj, ato më deklaruan se e kuptojnë atë, konstatova se palët e gjejnë Marrëveshjen Siguruese në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe te plotë, dhe Unë Noterja i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

#### BARRËMARRËSI

#### BARRËDHËNËSI

**"INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA**

**"GREEN COAST" SHPK**


Përfaqesuar nga:

Përfaqesuar nga:

Andi Çeku

Armando Alicanaj

Ermal Shyti

*Andi Çeku*  
*Ermal Shyti*  


*Armando Alicanaj*  
  


NOTERE





Handwritten text in blue ink, possibly a signature or a name, partially obscured by a curved line.

A circular stamp or seal, mostly illegible due to fading, located in the lower right quadrant of the page.

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L41329038D	
2. Data e Regjistrimit	29/01/2014	
3. Emri i Subjektit	GREEN COAST	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	29/01/2014	
6. Kohëzgjatja	Nga: 29/01/2014	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Tish Daija, kompleksi Kika 2, godina 3, kati 1.	
8. Kapitali	5.225.815.328,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	<p>Objekti përsor i veprimtarise se shoqerise eshte Projektimi, ndertimi, venia ne shfrytezim e nje kompleksi turistik, nje strukture hotelerie dhe e objekteve turistike sezonale ne Palase. Shitja e objekteve me destinacion rezidencial veror dhe/ose administrimi i tyre, si dhe ofrimi i sherbimeve te hoteleri-turizmit ne zone e Palases, si dhe cdo veprimtari tjeter plotesuese, qe lidhet direkt ose indirekt me vepimtarine e siperpermendur. Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose bleje/perfitoje direkt ose indirekt pjesemarrje, ne shoqeri, ndermarrje, agjenci apo siper marrje te tjera, te cilat kane fushe veprimtarie te ngjashme. Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo opercion tjeter qe ka te beje me pronen e paluajtshme, te luajtshme, cdo veprim apo operacion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te Shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe te mos alterojne objektin përsor te Shoqerise.</p>	
10. Administratori/ët	Armando Alicanaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 06/07/2022	Deri: 05/07/2025
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	11.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në	

